



Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosovo

Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

**RREGULLORE (AD) NR. 01/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E
RREGULLORES (AD) NR.05/2023
PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË
PUNËS NË AKADEMINË E DREJTËSISË**

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 17 paragrafit 1, nënparagrafit 1.10, si dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2025,
Miraton:

RREGULLORE (AD) NR. 01/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E RREGULLORES (AD) NR.05/2023 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AKADEMINË E DREJTËSISË

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotesimin e Rregullores (AD) NR.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë (ne tekstin ne vijim Rregullorja bazë).

Neni 2

Neni 20 i Rregullores baze ndryshohet si ne vijim:

Në të gjithë tekstin e nenit 20, përfshirë edhe titullin e tij, emërtesa „Zyrtar i lartë i Personelit” zëvendësohet me emërtesën „Zyrtar i lartë për burime njerëzore”.

Neni 3

Neni 21 i Rregullores baze ndryshohet si ne vijim:

Në të gjithë tekstin e nenit 21, përfshirë edhe titullin e tij, emërtesa „Zyrtari Certifikues” zëvendësohet me emërtesën „Zyrtari i Lartë Certifikues”.

Neni 4

1. Emërtesat e pozitive në Shtojcën 1 të Organogramit të Rregullores bazë, Zyrtari Certifikues dhe Zyrtari i Lartë i Personelit ndryshohet si në vijim:

1.1. Zyrtari Certifikues ndryshohet në Zyrtari i Lartë Certifikues;

1.2. Zyrtari i Lartë i Personelit ndryshohet në Zyrtari i Lartë për Burime Njerëzore.

Neni 5

Në Shtojcën 1 të Strukturës Organizative të Akademisë së Drejtësisë, të Rregullorës bazë emeritesat e pozitive dhe/apo Grupet si në vijim:

| Pozicioni/Struktura | Klasa | Grupi i përgjithshëm ose i veçantë | Numri/Totali |
|---|---------------|---|---------------------|
| 1.1. Zyrtar certifikues | Profesional 1 | Gr. Specialist i buxhetit dhe financave | 1 |
| 1.2. Zyrtar Ekzekutiv | Profesional 2 | 58.Gr. -Specialist i Administrimit të përgjithshëm | 1 |
| 2.4 - Zyrtar për statistika dhe analiza; | Profesional 2 | 58.Gr. -Specialist i Administrimit të përgjithshëm; | 1 |
| 3.1. - Zyrtar ligjor; | Profesional 2 | 1. Gr. Specialist ligjor | 1 |
| - Zyrtar i lartë gjuhësor; | Profesional 1 | 58.Gr. -Specialist i Administrimit të përgjithshëm | 1 |
| 3.2. - Administrator i Lartë i TI për sisteme; | Profesional 1 | 61. Gr. - Specialist i sistemeve të TIK | 1 |
| 3.3. - Zyrtar administrativ | Profesional 3 | 58.Gr.Specialist i Administrimit të Përgjithshëm | 1 |
| - Zyrtar i pasurisë | Profesional 2 | 4. Gr. Specialist i ekonomisë | 1 |
| 4. - Zyrtar për Shpenzime dhe financa | Profesional 2 | 3.Gr. Specialist i Buxhetit | 1 |
| - Zyrtar i lartë për buxhet | Profesional 1 | 4.Gr.Specialist i ekonomisë | 1 |

| | | | |
|---|---------------|---|----------|
| 4. Zyrtar i lartë i Personelit - Zyrtar i lartë i Personelit; | Profesional 1 | 7.Gr. Specialist i burimeve i NJerezore | 1 |
| 5. Zyrtari i Prokurimit - Zyrtar i Prokurimit | Profesional 2 | 5. Gr. - Specialist i prokurimit publik | 1 |

Ndryshohen si në vijim:


| | | | |
|---|---------------|---------------------------------------|----------|
| 1.1 Zyrtar i Lartë Certifikues | Profesional 1 | Grupi i ekonomisë | 1 |
| 1.2. Zyrtar Ekzekutiv | Profesional 2 | Grupi i shkencave shoqërore | 1 |
| 2.4 - Zyrtar për statistika | Profesional 2 | Grupi i statistikës | 1 |
| 3.1. - Zyrtar ligjor | Profesional 2 | Grupi ligjor | 1 |
| - Zyrtar i lartë për përkthime | Profesional 1 | Grupi i përkthimit dhe interpretimit | 1 |
| 3.2. - Zyrtar i lartë i TI-së për sisteme | Profesional 1 | Grupi i teknologjisë informative | 1 |
| 3.3. - Asistent administrativ | Profesional 3 | Grupi i Administrimit të Përgjithshëm | 1 |
| - Zyrtar i pasurisë | Profesional 2 | Grupi i ekonomisë | 1 |
| 4. - Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa | Profesional 1 | Grupi i buxhetit dhe financave | 1 |
| - Zyrtar për Shpenzime | Profesional 2 | Grupi i buxhetit dhe financave | 1 |

| | | | |
|--|---------------|----------------------------|----------|
| 5. Zyrtar i lartë për burime njerëzore - Zyrtar i lartë për burime njerëzore | Profesional 1 | Grupi i burimeve njerëzore | 1 |
| 6. Zyrtari për Prokurim - Zyrtar për prokurim | Profesional 2 | Grupi i prokurimit publik | 1 |

Neni 6
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Fejzullah Rexhepi


Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Prishtinë, 29/01/2025